



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 1700/2 Prot.

Vlorë, më, 05.11.2021

VENDIM
NR. 25, DATË 05. 10. 2021

PËR

PËRKTHIMIN NË GJUHËN ANGLEZE TË DOSJEVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER, PROFESIONAL DHE SHKENCOR.

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15. 02. 2017, Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe në Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, Vendimit Nr. 41, datë 24. 01. 2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Vendimit Nr. 185, datë, 25. 03. 2021 disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24. 01. 201 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimit Nr. 1, datë 14. 01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", në mbledhjen e zhvilluar në datën 05. 10 .2021, Rektorati

VENDOSI

1. Të miratojë përkthimin në gjuhën angleze nga çdo njësi bazë të kurrikulës së plotë të programeve të studimit Bachelor dhe Master Profesional dhe Shkencor: plani mësimor, rregullorja e programit të studimit, sillabuset, CV e pedagogëve dhe dokumentacioni mbështetës, vendimin e hapjes, vendimin e akreditimit, rregulloren e provimeve, planin mësimor të programit të studimit, kopje të marrëveshjeve kuadër dhe dokumentit të akreditimit të institucionit bashkëpunues në rast se ofrohet masteri në bashkëpunim me IAL-e tjera, tutullarët e lëndëve dhe profilin e tyre specifik.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë që ofrojnë këto programe studimi.

